

Si përdoret aplikacioni DGUV job?

Kështu mund ta instaloj aplikacionin:

Pjesëmarrja në aplikacion është për mua vullnetare. Të dhënat e hyrjes i marr drejtpërdrejt nga DGUV job.

Unë mund ta hap aplikacionin përmes faqes së internetit

www.jobbg-direkt.de/bewerber ose përmes kodit ta shkarkoj në telefonin tim. Për një qasje më të lehtë nga telefoni, mund të krijoh edhe një shkurtore në ekranin kryesor.

Menjëherë pas hyrjes së parë, duhet ta ndryshoj fjalëkalimin dhe pastaj mund të filloj menjëherë.

Mundësitë e mia:

Përmes MENYSË në faqen kryesore, afëi funksione të ndryshme:



Te të dhënat bazë mund të shoh dhe të ndryshoj të dhënat e mia të konatkatit dhe parametrat e kërkimit.

- Te PROPOZIME PUNËSIMI gjej oferta pune që janë interesante për mua. Kur ka oferta të reja pune, marr një e-mail dhe/ose SMS. Unë mund ta lexoj çdo ofertë pune me kujdes dhe të vendos nëse dhe në çfarë mënyre dua të aplikoj. Në hapin tjetër, zgjedh llojin e aplikimit duke klikuar opsionin përkatës. E di që aplikimi im personal ka suksesin më të madh, prandaj vendos me zgjuarsi!



- Te AKTIVITETI I PUNEVE mund të rilexoj vendimet dhe veprimet e mia për ofertat e punës.
- Te DOKUMENTET mund të kontrolloj CV-në dhe dëshmitë që kam ruajtur. Mund të ngarkoj një CV të re ose dokumente tjera. Kështu mbaj dokumentat e mia gjithëmonë të përditësuar.



- Te KONTAKTI mund t'i shkruaj drejtpërdrejt DGUV job. Për shembull, mund të njoftoj se kam marrë një ftesë për një intervistë pune, ose të transmetoj informacione të tjera.
- Me dalje përfundoj aktivitetet e mia në aplikacion.

Kam nevoj për ndihmë:

Nëse kam harruar fjalëkalimin ose kam pyetje, i drejtohem këshilltarit ose këshilltares time. Ose njërit nga personat e kontaktit:

www.dguv.de/job

DGUV job ju uron SUKSESE!